



Prania / Dorezuar Prishine/Pristina Recieved/Submitted	12.01.2024	4	viti год Year
Organ /Bërsa Organ /Institution Org. /Instit.	Di. Prist In. Prist Pr. /In.	Shtesa / Prilog Appendix	Sesi / Rechnung Disunity
SKMB/HEK	245/2024		118



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.577/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë si dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1714/2023 të datës 26.10.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.567/2019 të datës 23.09.2021 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.14-070/01-189452/19 të datës 26.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.01.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.567/2019 e datës 23.09.2019 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Anulohet Vendimi me numër Nr.14-116/01-184534/19 i datës 29.07.2019 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Prishtinës, si dhe Vendimi me numër Nr.14-070/01-189452/19 i datës 26.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës.**

**III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës "Inspektor i Ndërtimit", sipas Akt Emërimit me numër 01 nr.112-1050 të datës 01.08.2016 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës si dhe duke ia bërë kompensimin e pagës dhe kontributeve pensionale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.**

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Prishtinës sipas Akt Emërimit me numër 01 nr.112-1050 në pozitën e punës "Inspektor i Ndërtimit" në Drejtorinë e Inspektionit, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më datë 05.06.2019 ka parashtruar kërkesën me numër protokolli Nr.14-116/01-128756/19 për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor të Komunës së Prishtinës, me arsyetimin se ankuesi ka bërë shkelje të rregullores për procedurat disiplinore duke mos ofruar të dhënat e kërkuara nga drejtori në lidhje me një objekt në ndërtim e sipër për të cilin ekziston dyshimi se është pa leje.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore, më datë 20.06.2019, ka nxjerr Vendimin me numër Nr.2466, përmes së cilit ankuesit i ka shqiptuar masën e rëndë disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", ndërsa ankuesi kundër të njëjtit akt ka parashtruar ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, ndërsa ky i fundit përmes vendimit të datës 19.07.2023 ka aprovuar ankesën e ankuesit, duke e kthyer lëndën e ankuesit në rishqyrtim tek Komisioni Disiplinor. Komisioni Disiplinor pas rishqyrtimit të rastit me datë 29.07.2019 nxjerr Vendimin Nr.14-116/01-184534/19 përmes të cilit ankuesit i shqipton masën disiplinore.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin të datës 29.07.2019 të Komisionit Disiplinor, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, ndërsa më datë 26.08.2019 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Komunën e Prishtinës ka nxjerr Vendim me numër Nr.14-070/01-189452/19 përmes së cilit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi duke e lënë në fuqi Vendimin e datës 26.07.2019 të Komisionit Disiplinor përmes të cilit ankuesit i është lënë në fuqi masa e shqiptuar disiplinore "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës".

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.14-070/01-189452/19 të datës 26.08.2019, ka parashtruar ankesë me më datë 23.09.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i ankesave kanë dështuar të konstatojnë saktë gjendjen faktike dhe dëmin për shkeljen e supozuar, kanë zbatuar gabimisht apo nuk kanë aplikuar dispozitave të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative pasi që nuk kanë marra për bazë shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, arsyet pse dispozitat e tilla janë të zbatuara në rastin konkret dhe arsyet pse pretendimet palës nuk janë pranuar në procedurë të vendimmarrjes, nuk janë marrë për bazë fare dispozitat e ligjit material si dhe dispozitat e rregullores Nr.04/2011 për procedurat Disiplinore

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.09.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuese në Komunën e Prishtinës. Ndërsa Këshilli nga kjo e fundit Këshilli më datë 16.10.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020, si dhe nga data 30.06.2021 deri me datë 04.11.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka mundur të vendosë meritorisht për ankesën e ankuesit, ndërsa e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar të njëjtin që mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin me numër reference Nr.ref.567/2019 të datës 05.11.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ka hapur Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative, kurse Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin me numër A.nr.2686/19 të datës 01.05.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 05.11.2019, dhe duke detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që në afat prej 30 ditësh të vendosë lidhur me ankesën e datës 23.09.2019 të ankuesit

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.08.2021 përmes njoftimit me numër protokoll 4131/2021 ka njoftuar ankuesin se nga data 30.06.2021 ka mbetur pa anëtarë dhe Kolegje për vendimmarrje, andaj në këtë kuptim është e pamundur që Këshilli të vendosë për ankesën e ankuesit sepse në bazë të nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesat i shqyrton Kolegji prej tre (3) anëtarëve.

Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin me numër A.nr.1714/2021 të datës 26.10.2023 i cili në Këshill është regjistruar më datë 06.12.2023 dhe numër protokoll 7264/2023, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 06.08.2021, dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që në afat prej 30 ditësh të vendosë lidhur me ankesën e datës 23.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1714/2021 të datës 26.10.2023, Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative dhe dëshmime në shkresat e lëndës ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.1714/2021 të datës 26.10.2023 Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin me numër A.nr.2686/2021 të datës 01.05.2021 Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin me numër protokoll 4130/2021 të datës 06.08.2021; Ankesën me numër protokoll 4464/2019 të datës 23.09.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 14-070/01-189452/19 të datës 02.08.2019 të nxjerr nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën me numër protokoll 14-070/01-189452 të datës 02.08.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër 14-116/01184534/19 të datës 29.07.2019 të nxjerr nga Komisioni Disiplinor në Komunën e Prishtinës; Njoftimin me numër reference 14-116/01-128756/19 të datës 05.06.2019; Dëshmi lidhur me detajet e shkeljes së supozuar si dhe të raportuara të datës 03.06.2019; Raporti i një shkelje disiplinore të supozuar me numër protokoll 14-116/01-128756/19 të datës 05.06.2019; E-mail i datës 27.02.2019 nga B.TH drejtuar A.T; Raportin e objekteve deri më datë 27.02.2019 nga B.TH dhe M.A drejtuar L.ZH; Raportin Javor prej datës 16.04.2018 deri më 20.04.2018 të datës 23.04.2018; Raportin Javor prej datës 07.05.2018 deri më 11.05.2018 të datës 11.05.2018; Raportin Javor prej datës 25.06.2018 deri më 29.06.2018 të datës 03.07.2018; Raportin Javor prej datës 12.11.2018 deri më 16.11.2018 të datës 21.11.2018; Raportin Javor prej datës 21.01.2019 deri më 25.01.2019 të datës 05.02.2019; Raportin Javor prej datës 20.05.2019 deri më 24.05.2019 të dalës 20.05.2019 deri më 24.05.2019 të datës 31.05.2019; Raportin

Javor prej datës 27.05.2019 deri më 31.05.2019 të datës 10.06.2019; Njoftimin për rrënim të datës 31.05.2019; Aktvendimin me numër 09 Nr.354/02-0092621/18 të datës 27.05.2019 të lëshuar nga Inspektori i Ndërtimit B.TH; Fletë dorëzimit me Nr.014303 të datës 27.05.2019; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.354 të datës 27.05.2019 nga Drejtoria e Inspektionit; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.354 të datës 31.05.2019; Fletë dorëzimit me numër Nr. 014216 të datës 28.01.2019; Thirrje për palën Nr.014216vtë datës 25.01.2019; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.345 të datës 29.01.2019; Formularin për kërkesë apo ankesë me numër protokollit 05-356-32175 të datës 02.11.2010; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.354 të datës 13.11.2018; Procesverbalin për kontrollin inspektues Nr.354 të datës 26.06.2018; Aktvendimin me numër 09 Nr.354/02-0092621/18 të datës 08.05.2018; Fletë dorëzimit me Nr.354 të datës 08.05.2019; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.356 të datës 08.05.2018; Procesverbalin për kontrollin inspektues me Nr.356 të datës 24.04.2018; Fletë dorëzimit me Nr.354 të datës 24.04.2018; Aktvendimin me numër 09 Nr.354/02-0092621/18 të datës 17.04.2018; Kopjen e planit të datës 21.03.2018; Certifikatën të datës 21.03.2018 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor; Aktvendimin me numër 09 Nr.354/02-0092621/18 të datës 18.04.2018; Kopjen e letërnjoftimit me numër 875136 të datës 23.05.2017; Autorizimin për përfaqësim me numër Nr.919/2018 të lëshuar nga noteri F.M; Procesverbalin për kontrollin inspektues me numër Nr.356 të datës 17.04.2018; Thirrje për palën me numër Nr.354 të datës 16.04.2018; Fletë dorëzimit me numër Nr.354 të datës 17.04.2018; Mbështjellësin e lëndës me numër 09-354/02 0092621/18 të datës 18.04.2018; Komunikimet elektronike të datës 08.02.2021; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 4867/2019 të datës 16.10.2019; Përshkrimin e Detyrave të punës; E-mailin e datës 20.05.2019 nga A.T drejtuar B.TH.; E-mailin e datës 21.05.2019 nga B.TH drejtuar A.T; E-mailin e datës 22.05.2019 nga B.TH drejtuar A.T; Dëshminë e datës 18.04.2018; E-mailin e datës 19.06.2019 nga O.B drejtuar M.LL; Procesverbalin nga Komisioni Disiplinor të datës 19.06.2019; E-mailin e datës 15.10.2019 të O.B drejtuar M.LL; Përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit me numër 01 Nr.112-1050 të datës 01.08.2016, Njoftimin e datës 06.08.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në procedurë të shqyrtimit për vendosjen e kësaj çështje administrative, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të iniciuar nga Kryetari i Komunës, me Vendimin e datës 29.07.2019 ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore dhe i ka shqiptuar të njëjtit masën disiplinore "Ndërprerje të marrëdhënies së punës" me arsyetimin se i njëjti është përgjegjës për shkeljen e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafit 1.10 dhe 1.8 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ngase nuk ka raportuar për ndërtimin pa leje të një objekti në lagjen Mati I.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: "Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me vepër penale, siç është përcaktuar me këtë ligj." si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: "1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor" si dhe "2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda - serioze të cilat do të rregullohen

me akt nënligjor “ si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 dhe 1.18 i cili përcaktonë se: “shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror; 1.18, Fshelja e fakteve apo të dhënave zyrtare kur ato kërkohen për qëllime zyrtare”, dhe Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mund t’i shqiptohet masë disiplinore mirëpo vetëm pasi që të konstatohet saktë gjendja faktike dhe pas shqyrtimit të provave dhe fakteve në procedurë administrative sikurse përcaktohet me dispozitat e LPPA-së, ndërsa më pastaj nëse pala eventualisht gjendet përgjegjës masat duhet të jenë graduale dhe në proporcion më shkeljen e kryer pas konstatimit të dëmit të shkaktuar.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënies së punës” sipas vendimit të datës 29.07.2019, me numër protokolli 14-116/01-184534/19, përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa më e rëndë disiplinore në shërbimin civil “ndërprerje e marrëdhënies së punës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 71, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3, të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: “1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar” ngase ka dështuar të realizojë veprimet procedurale mungesa e të cilave ka ardhur deri te konstatimi i gabuar i gjendjes faktike, respektivisht nuk janë marrë për bazë provat të cilat i mbështesin pretendimet e ankuesit ngase se i njëjti i ka ndërmarrë veprimet procedurale sipas obligimeve ligjore që ka, kurse Kolegji i Këshillit ka arritur të konstatoj se ankuesi në cilësi të Inspektorit të Ndërtimit kishte përgatitur raport të detajuar të datës 27.02.2019 të cilin ia ka dërguar U.D Shefit të Sektorit të Ndërtimit në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për gjendjen e ndërtimit të 64 njësive e banesore (duke përfshirë apo evidentuara ato që janë me leje, pa leje apo rasteve kur ka vendime të konfirmuara për rrënim, në mesin e të cilave është evidentuar edhe rasti i kontestuar sipas palës), po ashtu raportin javor të datës 23.04.2018 për periudhën kohore 16.04.2018-20.04.2018 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 16 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarra, po ashtu raportin javor të datës 11.05.2018 për periudhën kohore 07.05.2018-11.05.2018 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 15 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarra procedurale, po ashtu raportin javor të datës 03.07.2018 për periudhën kohore 25.06.2018-29.06.2018 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 2 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarra, po ashtu raportin javor të datës 21.11.2018 për periudhën kohore 12.11.2018-16.11.2018 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 13 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarra, po ashtu raportin javor të datës 05.02.2019 për periudhën kohore 21.01.2019-25.01.2019 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 3 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarre, po ashtu raportin javor të datës 31.05.2019 për periudhën kohore 20.05.2019-24.05.2019 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 6 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarre, po ashtu raportin javor të datës 10.06.2019 për periudhën kohore 27.05.2019-31.05.2019 në të cilin raport bëhet përshkrimi në mënyrë të detajuar për evidentimin e 11 rasteve lidhur me objektet ndërtimore, me përshkrimin edhe të masave dhe veprimeve të ndërmarre, po ashtu është konstatuar faktin se Drejtoria e Inspektionit me darë 31.05.2019 ka bërë njoftimin për rrënimin sipas aktvendimit të datës 27.05.2019 të nxjerrë nga vetë

ankuesi, sikurse dëshmohet fakti se ankuesi me datë 13.11.2018 për të njëjtin rast ka nxjerr Aktvendimin me shifër 09Nr. 354/02-0092621/18 përmes të cilit ia ka ndërprere punimit për mbindërtim të njëjtit objekt kontestues ku ankuesi supozohet të jetë përgjigjes dhe se për veprimet e tilla ankuesi i ka mbështetur me dokumente zyrtare të cilat kanë marrë numra të regjistrit zyrtar të Komunës së Prishtinës, prandaj supozimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe konstatimit e Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës të shprehur përmes Vendimit të datës 29.07.2019 janë konstatime të gabuara ngase nuk mund të arrihet në përfundimin se ankuesi nuk i ka informuar organet komunale për një objekt pa leje përderisa e ankuesi e dokumenton me të gjitha shkresat e lartcekura dhe prova të tjera zyrtare ku madje janë ndërmarrë edhe veprime konform autorizimeve ligjore nga ankuesi në fjale.

Duke marrë për bazë dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. *vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, ose*" ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "*Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative*" Kolegji i Këshillit konstatoi se ashtu sikurse Komisioni Disiplinor edhe Komisioni i ankesave kanë dështuar të zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ngase nuk kanë marrë për bazë apo nuk ka shqyrtuar drejtë faktet në procedurë të vendimmarrjes, fakte të cilët dëshmojnë të kundërtën e arsyes sipas së cilës është iniciuar procedura disiplinore e datës 05.06.2019 ku thuhet se: "*i punësuar në Drejtorinë e Inspektionit ka bërë shkelje të Rregullores për Procedurat Disiplinore duke mos ofruar të dhënat e kërkuara nga drejtoria në lidhje me një objekt në ndërtim e sipër, për të cilin ekzistonin dyshimet e bazuara se është pa leje. Me mos përgjigje dhe mos veprim zyrtari në fjalë ka vonuar veprimet të cilat është dashur të merren në lidhje me rastin lartë cekur i cili ka të bëjë me Vendim për rrënim*", përderisa ekzistojnë raporte punë dhe aktvendime të ndërmarra nga ankuesi në data të mëhershme që dëshmojnë të kundërtën e konstatimit në shkresën për inicim të procedurës disiplinore, respektivisht me datën 27.05.2019, me numër protokolli 09, Nr. 354/02-0092621/18, Drejtoria e Inspektionit e Komunës së Prishtinës, ka nxjerr aktvendim me të cilin ka urdhëruar të bëjë rrënimin e objektit i ekzistuese P+2, të ndërtuar në Prishtinë lagja Mati 1 rruga " " prandaj mbi këtë bazë Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 29.07.2019 është akt administrativ i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material*".

Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimit të Komisionit Disiplinor i mungon arsyetimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase vendimi përkatësisht arsyetimi i vendimit duhet që të ketë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilin është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, andaj arrihet në konstatimin se Komisioni Disiplinor duke mos saktësuar shkeljet dhe përgjegjësitë e ankuesit me veprimet dhe mosveprimet e tija ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 64, 65 dhe 66 të Ligjit Nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës prandaj pretendimet ankimore të

ankuesit janë të bazuara, ndërsa Vendimi i Komisionit Disiplinor është anuluar sikurse në dispozitiv e këtij vendimi.

Po ashtu, Komisioni Disiplinor përveç konstatimit të gabuar të gjendjes faktike mos shqyrtimit të provave dhe fakteve e më pastaj ka bërë zbatim të gabuar të ligjit material, gjegjëshit nuk ka arritur të konstatoi se cili është dëmi i shkaktuar të cilit iu ka referuar Komisioni Disiplinor në masën e shqiptuar disiplinore, ngase dëmi duhet të jetë i matshëm dhe jo i supozuar sikurse duhet të eksitoj lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe fajit e që në rrethanat e rastit konkret Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 29.07.2019 ka dështuar të konstatoje një çështje të tillë, prandaj pretendimet e ankuesit janë të bazuara sikurse në ankesën e parashtruar të datës 23.09.2019.

Ndërsa nga Komuna e Prishtinës, po ashtu me rastin e marrjes së përgjigjes në ankesë janë njoftuar me pretendimet ankimore të ankuesit, ndërsa në përgjigjen e tyre të datës 16.10.2019 nuk arritur të argumentojnë pretendimin e tyre në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore përveç që kanë kthyer përgjigje, të gjeturat e tyre nuk i kanë mbështetur me prova të nevojshme, gjegjësisht nuk ofruar faktet mbi bazën e të cilave ankuesi është gjetur përgjegjës, përderisa ankuesi ka mbështetur secilin argument me prova përkatëse, shkresa këto të cilat kanë qarkulluar brenda strukturës organizative të Komunës së Prishtinës me të cilat kanë mundur të disponojnë.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i këshillit konstaton se edhe Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunë të Prishtinës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 26.08.2019, përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Vendimin me numër 29.07.2019 të Komisionit Disiplinor, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj sikurse Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 29.07.2019 edhe Vendimi i Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunë të Prishtinës është akt administrativ i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë është anuluar sikurse në dispozitiv e këtij vendimi

Andaj, mbi bazë të provave të administruara të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe arsytimit të dhënë në këtë vendim, konstaton se ekziston baza ligjore për aprovimin e ankesës së ankuesit ashtu që Komuna e Prishtinës është e obliguar që të zbatojë vendimin e Këshillit duke e kthyer ankuesin në vendin e punës sipas Aktit të Emërimit me numër 01 Nr.112-1050 të datës 01.08.2016 në pozitën e punës "Inspektor i Ndërtimit", dhe po ashtu të njëjtit duhet t'ia kompensoj të ardhurat personale sipas Aktit të Emërimit që nga momenti ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në momentin e kthimit në vend të punës sipas këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër **A.nr.577/2021**

**Kaltrina Avdullahi-Prenaj**

*[Signature]*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

*[Signature]*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës :
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së